



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 626, datë 10.12.2020**

**PËR**  
**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}**  
**TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË**  
**GJYKATËN E APELIT TIRANË, PËR DY POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË**  
**DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 394, NR. 395 DATË**  
**07.10.2020 DHE PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË**  
**SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 396, DATË 07.10.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË**  
**GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E**  
**TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 394, nr. 395 dhe nr. 396 datë 07.10.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e saj, znj. Marçela Shehu,

**VENDOSI:**

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë (në fushën civile), për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394 dhe nr. 395 datë 07.10.2020 dhe në (fushën penale), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 396, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë (në fushën civile), për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394 dhe nr. 395 datë 07.10.2020 dhe në (fushën penale), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 396, datë 07.10.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**